



RREGULLORE NR.12

“MBI MASAT E VIGJILENCËS SË DUHUR DHE TË ZGJERUAR NGA SUBJEKTET E LIGJIT MBI PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT”

Miratur me Vendimin Nr. 12, datë 02.07.2020 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike

Kreu I

Të përgjithshme

Neni 1

Baza ligjore

1. Kjo rregullore hartohet në bazë të nenit 3, nenit 5, të Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, nenit 24, pika 2 të Ligjit Nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit”, i ndryshuar, pika 1, gërma ë, pika 2 e VKM Nr. 343, datë 08.04.2009 “Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të autoriteteve licensuese dhe/ose mbikëqyrëse”, i ndryshuar, nenit 7 të Ligjit Nr. 157/2013 “Për masat e marra kundër financimit të terrorizmit”, i ndryshuar.

Neni 2

Objekti

1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave dhe dokumentacionit për identifikimin e klientit, regjistrimin, ruajtjen e të dhënave dhe raportimin e tyre tek autoriteti përgjegjës, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), nga subjektet e kësaj rregulloreje.

Neni 3

Qëllimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim parandalimin e përdorimit të subjekteve për pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit.

Neni 4



Subjektet

1. Subjekte të kësaj rregulloreje janë subjektet e përcaktuara në gërmën “gj” të nenit 3 të Ligjit Nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, si dhe VKM Nr. 343 datë 08.04.2009 “Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të autoriteteve licensuese dhe/ose mbikëqyrëse” .

Neni 5

Përkufizime

1. **“Autoritet përgjegjës”** është Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP).
2. **“Autoritet mbikëqyrës”** është Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP).
3. **“Vigjilencë e thjeshtuar”** është një tërësi masash që zbatohet nga subjektet e ligjit për vendosjen dhe monitorimin e marrëdhënies së biznesit me klientët, produktet dhe shërbimet e ofruara, të cilët paraqesin një nivel të ulët risku për pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit.
4. **“Vigjilenca e duhur”** është tërësia e masave që duhet të aplikojnë subjektet, me qëllim identifikimin dhe verifikimin e plotë dhe të saktë të klientëve, pronarit përfitues përfundimtar, strukturës së pronësisë dhe të kontrollit për personat juridikë dhe organizimet ligjore, natyrën dhe qëllimin e transaksionit apo marrëdhënies, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit dhe të shqyrtimit të vazhdueshëm të transaksioneve, për të siguruar që janë në përputhje me natyrën e biznesit të klientit dhe profilet e rrezikut, duke përfshirë, kur është e nevojshme, burimin e fondeve.
5. **“Vigjilencë e zgjeruar ndaj klientit”** është një proces më i thellë kontrolli, përtej procedurave “Njih klientin tënd”, si dhe masave të “Vigjilencës së duhur”, që synon të krijojë sigurinë e mjaftueshme për të verifikuar dhe vlerësuar:
 - a) identitetin e klientit;
 - b) për të kuptuar dhe testuar profilin e klientit, të biznesit dhe veprimtarisë së tij lidhur me shërbimet, produktet dhe transaksionet e ofruara nga subjekti;
 - c) për të identifikuar informacionet me rëndësi dhe për të vlerësuar rrezikun e mundshëm për pastrim parash/financim terrorizmi, në mbështetje të vendimeve që synojnë mbrojtjen nga rreziqet financiare, rregullatore apo reputacionale, si dhe përshtatjen ndaj kërkesave ligjore.
6. **“Procedura njihje klientin tënd”** nënkupton një sërë rregullash, të përdorura nga subjektet e këtij ligji, që kanë të bëjnë me politikat e pranimit e të identifikimit të klientit dhe administrimit të riskut të tyre.
7. **“Subjekt/e i/të mbikëqyrur/a”** është audituesi ligjor/shoqëria e auditimit dhe kontabilisti i miratuar/shoqëria e kontabilitetit, që ushtrojnë profesionin si person fizik dhe/ose juridik, që vendos marrëdhënie biznesi me klientë, gjatë veprimtarisë së tij normale apo si pjesë e veprimtarisë tregtare ose profesionale të tij.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

8. **“Ligji për PPP/FT”** është Ligji Nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar.
9. Designated Non-Financial Businesses and Professions (DNFBP) – Profesionet e lira të caktuara jo-financiare
10. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave – DPPPP.
11. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorur në Ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, dhe Ligjin nr. 157, datë 10.10.2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre.

Kreu II

Masat e vigjilencës së duhur

Neni 6

Vigjilenca e thjeshtuar

1. Vigjilenca e thjeshtuar ndaj klientëve mund të kryhet në rastet kur identifikohet rrezik i ulët për pastrim parash dhe/ose financim të terrorizmit, bazuar në vlerësimet e riskut të autoriteteve të ngarkuara me ligj, si dhe vlerësimet e rrezikut dhe të procedurave të menaxhimit të përcaktuara nga vetë subjektet e ligjit. Në vlerësimin e rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, që lidhen me llojin e klientëve, zonës gjeografike, produkteve, shërbimeve, transaksioneve apo kanaleve të veçanta të shpërndarjes, subjektet e këtij ligji marrin parasysht faktorët dhe situatat e parashikuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Gjatë zbatimit të vigjilencës së thjeshtuar, subjektet mund:
 - i) të ulin frekuencën e përditësimit të të dhënave për procesin e identifikimit, si dhe shkallën e monitorimit të vazhdueshëm;
 - ii) të mos mbledhin informacion specifik apo të ndërmarrin masa specifike për të kuptuar qëllimin dhe natyrën e marrëdhënies së biznesit në çdo rast, por mund ta përcaktojnë këtë në bazë të marrëdhënies së biznesit të vendosur.
3. Vigjilenca e thjeshtuar e klientit mund të kryhet vetëm kur monitorimi i marrëdhënieve të biznesit të klientit vazhdon të kryhet gjatë ose pas vigjilencës së thjeshtuar të klientit dhe ekziston mundësia për të identifikuar transaksionet e pazakonta apo të dyshimta.
4. Në rast se, gjatë kryerjes së monitorimit të vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me klientin, vlerësohet apo ka element për të besuar se nuk është më i ulët rreziku i pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, veprave penale ose veprimtarive kriminale që gjenerojnë produkte të veprës penale, subjektet janë të detyruara të marrin masat e plota për zbatimin e vigjilencës së duhur sipas nenit 8 të kësaj rregullore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

5. Vigjilenca e thjeshtuar nuk mund të zbatohet në rastet kur ka dyshime për pastrim parash, financim terrorizmi, vepra penale ose veprimtari kriminale që gjenerojnë produkte të veprës penale, si dhe kur zbatohet vigjilenca e zgjeruar apo skenarë specifike risku të lartë.

6. Ndalohet kryerja e vigjilencës së thjeshtuar ndaj kategorive të klientëve kur kjo vendoset nga autoriteti përgjegjës.

Neni 7

Vigjilenca e duhur

1. Koncepti i “vigjilencës së duhur ndaj klientit” është një procedurë më e zgjeruar se procedura “njih klientin tënd” dhe identifikimi i klientit është vetëm një prej elementeve të tij.

Vigjilenca e duhur ndaj klientit është një proces dinamik dhe i vazhdueshëm, i cili përbëhet nga masa të detyrueshme që subjekteve iu kërkohet të përmbushin:

a) identifikimi i klientit dhe verifikimi i këtij identifikimi nëpërmjet dokumenteve, të dhënave dhe informacioneve të tjera, nga burime të besueshme dhe të pavarura. Identifikimi dhe verifikimi janë dy procese të ndara, por plotësuese të njëra-tjetrës;

b) identifikimi i pronarit përfitues (personit fizik) dhe verifikimi i këtij identifikimi, duke ndërmarrë masa të arsyeshme në mënyrë që subjektet të krijojnë bindjen se kush është pronari përfitues përfundimtar.

Në rastin e personave juridikë dhe organizimeve ligjore, masat e marra duhet të përfshijnë njohjen e pronësisë dhe strukturës së kontrollit të tyre.

c) mbledhja e informacionit mbi qëllimin dhe natyrën e caktuar të marrëdhënieve të biznesit;

ç) kryerjen e monitorimit të vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit dhe të shqyrtimit të transaksioneve, për t’u siguruar që janë në përputhje me natyrën e biznesit të klientit dhe profilin e rrezikut, duke përfshirë, kur është e nevojshme, edhe burimin e fondeve.

2. Në zbatim të neneve 4, 4/1 dhe 5 të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, subjektet duhet të bëjnë identifikimin e klientëve (të përhershëm apo rastësorë) dhe verifikimin e identitetit të tyre me anë të burimeve të pavarura dhe të besueshme nëpërmjet dokumenteve të vlefshme origjinale ose fotokopje të noterizuara:

a) Për individët dhe përfaqësuesit ligjorë:

- Letërnjoftim ID ose pasaportë brenda afatit të skadencës (kartë identiteti);
- Pasaportë brenda afatit të skadencës; Për individë jorezidentë:
- Pasaportë, brenda afatit të skadencës.
- ID kartë identiteti (vetëm për vendet e BE-së) brenda afatit të skadencës.

b) Për personat fizikë dhe juridikë që zhvillojnë veprimtari fitimprurëse:

- Statuti;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

- Akti i themelimit;
 - Ekstrakte të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;
 - Çertifikatë regjistrimi të personit të tatueshëm (NUIS/NIPT). Për shoqëri jorezidente:
 - Dokumentacioni që vërteton regjistrimin e shoqërisë së huaj në vendin e residences (vendim i gjykatës ose ekstrakt nga regjistri tregtar);
 - Statuti i shoqërisë;
 - Dokumenti i identifikimit të personave të autorizuar.
- c) Për personat juridikë që nuk zhvillojnë veprimtari fitimprurëse:
- Akti i themelimit;
 - Statuti;
 - Vendimin e gjykatës për regjistrimin si person juridik ose dokumentacionin ekuivalent përkatës;
 - Çertifikatë regjistrimi të personit të tatueshëm (NUIS/NIPT).
3. Dokumente të tjera shtesë që mund të kërkohen nga subjekti, por pa u kufizuar vetëm në to, sipas nevojës për identifikimin dhe për verifikimin e identitetit të klientit, si dhe në të gjitha rastet kur ka të dhëna ose dyshime për pastrim parash ose financim të terrorizmit, janë:
- a) Për individët dhe përfaqësuesit ligjorë:
- Çertifikata të lëshuara nga zyrat e gjendjes civile;
 - Leje drejtimi e automjetit;
 - Leje hyrje apo qëndrimi për të huajt;
 - Libreza apo kontratë pune;
 - Kontrata e blerjes/qirasë së banesës;
 - Kontrata me operatorë shërbimesh, si: telefon fiks, celular, ujë, energji elektrike etj;
 - Vërtetim vendbanimi të lëshuar nga autoritetet vendore.
- b) Për personat fizikë dhe juridikë që zhvillojnë veprimtari fitimprurëse:
- Çertifikatë regjistrimi të personit të tatueshëm;
 - Leje/licencat të ushtrimit të aktivitetit;
 - Kontrata e blerjes/qirasë së selisë dhe vendit të ushtrimit të aktivitetit.
- c) Për personat juridikë që nuk zhvillojnë veprimtari fitimprurëse:
- Leje/licencat të ushtrimit të aktivitetit;
 - Kontrata e blerjes/qirasë së selisë dhe vendit të ushtrimit të aktivitetit.
4. Masat e vigjilencës së duhur duhet të zbatohen nga vetë subjektet dhe mbështetja në palë të treta nuk është e lejueshme.
5. Subjektet duhet të identifikojnë dhe të verifikojnë identitetin e pronarit përfutues përfundimtar (i cili duhet të jetë gjithmonë person fizik), duke kërkuar dokumente shtesë, të cilët provojnë identitetin dhe lidhjen e pronarit përfutues me personin juridik dhe me atë që kryen transaksionin.



6. Në rastet kur klienti apo pronari përfitues është një kompani aksionare e listuar në një bursë të njohur financiare jashtë vendit dhe është subjekt i detyrimeve për raportim në një autoritet rregullator, nuk është e nevojshme të identifikohet dhe verifikohet identiteti i aksionarëve të kompanisë. Për qëllime të kësaj rregulloreje, bursë e njohur financiare do të konsiderohen bursat e vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim.

Neni 8

Masat e vigjilencës së duhur

Në kuadrin e zbatimit të vigjilencës së duhur ndaj klientit subjektet duhet:

1. Të hartojnë e të zbatojnë rregullore dhe udhëzime të brendshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në të cilat përfshihen procedurat për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut në marrëdhëniet e biznesit, për zbatimin e masave për vigjilencën e duhur dhe atë të zgjeruar ndaj klientit në përputhje me nivelin e rrezikut; për mbajtjen e të dhënave; për raportimin e aktivitetit të dyshimtë dhe transaksioneve mbi pragun e raportimit, si dhe për trajnimin e stafit të tyre.
2. Të identifikojnë klientin (të përhershëm apo rastësor, person fizik apo juridik) dhe të verifikojnë identitetin e tij.
3. Të përcaktojnë për të gjithë klientët, para vendosjes së marrëdhënieve të biznesit apo gjatë procesit të monitorimit të kësaj marrëdhënieje, nëse ata janë duke vepruar në emër të një personi tjetër dhe të marrin masa të arsyeshme për të siguruar të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e atij personi dhe verifikimin e të dhënave.
4. Të marrin masat e mëposhtme për klientët që janë persona juridikë ose organizime ligjore:
 - a) Të verifikojë nëse çdo person që vepron në emër të klientit të tij është i autorizuar dhe të identifikojë e verifikojë identitetin e tij;
 - b) Të verifikojë statusin ligjor të tyre nëpërmjet dokumenteve të themelimit dhe regjistrimit ose fakteve të ngjashme të ekzistencës së tyre dhe të sigurojë informacion në lidhje me emrin e klientit, emrat e kujdestarëve dhe përfituesve (për organizimet ligjore), formën ligjore, adresën, drejtuesit (për personat juridikë) dhe dispozitat që rregullojnë marrëdhëniet juridike;
 - c) Të kuptojnë strukturën e pronësisë dhe kontrollit të klientit;
 - ç) Të verifikojë pronarin përfitues dhe të marrë masa të arsyeshme për të verifikuar identitetin e tij, nëpërmjet informacioneve përkatëse ose të dhënave të siguruar nga burime të besueshme në bazë të të cilave subjekti njeh se kush janë pronarët përfitues;
 - d) Të përcaktojë individët të cilët zotërojnë dhe kanë kontrollin e fundit mbi klientin. Këtu përfshihen ata individë që ushtrojnë kontrollin e fundit efektiv mbi personin juridik ose mbi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

organizimet ligjore. Për personat juridikë, kjo duhet të përfshijë dhe identifikimin e personave fizikë të cilët përbëjnë pjesën vendimmarrëse dhe menaxhuese të personit juridik. Në rast të organizimeve ligjore kjo përfshin dhe identifikimin e themeluesit, të përfituesit, të kujdestarit ose të personit me një kontroll faktik mbi to.

5. Të sigurojnë informacion për qëllimin dhe natyrën e caktuar të marrëdhënies së biznesit, mbi bazën e të cilit mund të ndërtojnë profilin e rrezikut të klientit. Profili i rrezikut duhet t'u shërbejë subjekteve për të përcaktuar dhe zbatuar masat e vigjilencës së duhur dhe asaj të zgjeruar ndaj klientit.

6. Të përcaktojnë procedurat dhe mjetet e menaxhimit të rrezikut për rastet kur mund të hyjnë në një marrëdhënie biznesi me klientin, përpara ose gjatë identifikimit të tij.

Këto procedura, ndër të tjera, duhet të përfshijnë masa për kufizimin e numrit, të llojit dhe/ose të shumës së transaksioneve që mund të kryhen, si dhe monitorimin e transaksioneve në vlera të larta apo komplekse, të kryera jashtë profilit të pritshëm për veçoritë e kësaj marrëdhënieje.

Marrëdhënia e biznesit mund të vendoset para apo gjatë verifikimit të identitetit të klientit vetëm në rastet kur:

- verifikimi realizohet sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur;
- është e nevojshme për të mos ndërprerë vazhdimin normal të aktivitetit të biznesit të subjektit;
- rreziku i pastrimit të parave menaxhohet në mënyrë efektive nga subjekti.

7. Të zbatojnë masat e vigjilencës së duhur edhe për klientët ekzistues, pavarësisht nivelit të riskut të ekspozimit ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Këto masa të vigjilencës së duhur ndaj klientit zbatohen të paktën kur:

- transaksioni mund të jetë jashtë profilit të biznesit të klientit;
- standardet e dokumentacionit të klientit ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme;
- ka një ndryshim thelbësor në përdorimin e llogarisë;
- është konstatuar se mungon informacion i mjaftueshëm për klientin.

Lista e mësipërme nuk është gjithëpërfshirëse dhe shteruese në zbatimin e masave të vigjilencës së duhur për klientët ekzistues.

8. Struktura dhe/ose personi përgjegjës/e, brenda subjektit, për pajtueshmërinë duhet të marrë masat parandaluese për zbulimin dhe korrigjimin e mangësive të gjetura, si dhe përmirësimin e sistemeve të brendshme për zbulimin e transaksioneve dhe personave të dyshuar për pastrim parash ose financim të terrorizmit. Në këtë kuadër subjektet duhet të kryejnë kontrolle dhe analiza të funksionimit të sistemit parandalues në përputhje me rregulloret dhe procedurat e hartuara dhe miratuara për këtë qëllim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Në rast se ndodhin ndryshime në marrëdhënien e biznesit të klientit (si pasojë e ndryshimeve organizative të klientit, shërbimeve apo produkteve të reja, marrëdhënieve të reja kontraktuale apo të biznesit brenda ose jashtë vendit. Struktura dhe/ose personi përgjegjës/e i subjektit duhet, ndër të tjera, të vlerësojë monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit dhe të sigurojë që kjo marrëdhënie vijon të jetë në përputhje me profilin e ndryshuar të klientit.

Subjektet duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë çdo rreziku që vjen nga përdorimi i teknologjive të reja, në zhvillim ose nga produkte, transaksione që mund të favorizojnë anonimitetin dhe të marrin masa, nëse nevojitet, për të parandaluar përdorimin e tyre për pastrim parash apo financim terrorist.

Neni 9

Vigjilenca e zgjeruar

1. Vigjilenca e zgjeruar duhet të përfshijë masa shtesë, përveç atyre të parashikuara për vigjilencën e duhur, për marrëdhëniet e biznesit, klientët apo transaksionet me rrezik të lartë. Për zvogëlimin e rrezikut të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, krahas kategorive të përcaktuara në ligj dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, subjektet përcaktojnë kategori të tjera marrëdhëniesh biznesi, klientësh dhe transaksionesh, të vlerësuara me rrezik të lartë dhe ndaj të cilave duhet të zbatohen masat e vigjilencës së zgjeruar.
2. Për zbatimin e vigjilencës së zgjeruar ndaj klientëve, subjektet duhet të kërkojnë praninë fizike të klientëve dhe të përfaqësuesve të tyre, para se të vendosin një marrëdhënie biznesi.
3. Kur subjektet janë të paafta që të plotësojnë detyrimet për vigjilencën e zgjeruar ndaj klientit, ato duhet të zbatojnë masat e parashikuara në pikën 2, të nenit 8 të kësaj rregulloreje.

Neni 10

Kategoritë e klientëve ndaj të cilëve zbatohet vigjilenca e zgjeruar

1. Për personat e ekspozuar politikisht, subjektet duhet:
 - a) të hartojnë dhe të zbatojnë sisteme efektive të menaxhimit të riskut për të përcaktuar nëse një klient ekzistues apo potencial ose pronari përfitues është një person i ekspozuar politikisht;
 - b) të marrin miratimin e drejtuesve të lartë për vendosjen e marrëdhënieve të biznesit me personat e ekspozuar politikisht;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

- c) të kërkojnë dhe të marrin miratimin e drejtuesve të lartë për vazhdimin e marrëdhënies së biznesit, në rastet kur marrëdhënia e biznesit me klientin është vendosur dhe subjekti konstaton që klienti apo pronari përfitues është bërë ose bëhet më pas person i ekspozuar politikisht;
- ç) të marrin masa të arsyeshme për të kuptuar burimin e pasurisë dhe të fondeve të klientëve e të pronarëve përfitues, të identifikuar si persona të ekspozuar politikisht.
2. Në rastet kur subjektet kanë një marrëdhënie biznesi me personat e ekspozuar politikisht, ata duhet të mbikëqyrin me vigjilencë të zgjeruar këtë marrëdhënie.
3. Për klientët, të cilët janë organizata jofitimprurëse, subjektet duhet:
- a) të mbledhin informacione të mjaftueshme për to, për të kuptuar plotësisht burimet e financimit, natyrën e veprimtarisë dhe mënyrën e administrimit dhe drejtimit të tyre;
- b) të përcaktojnë nëpërmjet informacionit publik ose me mjete të tjera reputacionin e tyre;
- c) të marrin miratimin nga instancat më të larta të administrimit/drejtimit përpara vendosjes së një marrëdhënieje biznesi me ta;
- ç) të ofrojnë monitorim të zgjeruar të marrëdhënies së biznesit.
4. Subjektet duhet t'u kushtojnë vigjilencë të zgjeruar marrëdhënieve të biznesit dhe transaksioneve me klientët jorezidentë, veçanërisht kur këto transaksione kryhen pa praninë fizike të klientit.
5. Subjektet duhet të verifikojnë dhe t'u kushtojnë vigjilencë të zgjeruar marrëdhënieve të biznesit dhe transaksioneve me të gjitha kategoritë e klientëve, të cilët banojnë ose e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në vende për të cilat kërkohet marrja e masave të posaçme, sipas përcaktimeve apo kërkesave të autoritetit përgjegjës. Subjektet duhet të analizojnë arsyet dhe qëllimin e kryerjes së transaksioneve të tilla dhe të mbajnë të dhëna me shkrim për konkluzionet, të cilat duhet t'u vihen në dispozicion autoritetit mbikëqyrës, nëse kërkohet. Autoriteti mbikëqyrës mund të kërkojë marrje masash shtesë dhe kufizime përtej vigjilencës së zgjeruar.
6. Subjektet duhet t'u kushtojnë vigjilencë të zgjeruar marrëdhënieve të biznesit dhe transaksioneve me klientë organizimet ligjore apo shoqëritë që kanë aksione të mbajtësit, transaksioneve të kryera në emër apo për llogari të tyre, si dhe kur organizimet ligjore apo shoqëritë që kanë aksione të mbajtësit janë pjesë e strukturës së pronësisë, kontrollit apo vendimmarrjes së klientëve të tyre.
7. Subjektet duhet t'u kushtojnë vigjilencë e zgjeruar të gjitha transaksioneve komplekse, me vlera të larta dhe të pazakonta, të cilat nuk kanë qëllim të dukshëm ekonomik ose ligjor. Subjektet duhet të analizojnë arsyet dhe qëllimin e kryerjes së transaksioneve të tilla dhe të mbajnë të dhëna me shkrim për konkluzionet, të cilat duhet t'u vihen në dispozicion autoritetit përgjegjës, autoriteteve mbikëqyrëse nëse kërkohet.
8. Subjektet duhet t'u kushtojnë vigjilencë të zgjeruar marrëdhënieve të biznesit dhe transaksioneve me klientë, të cilët vetë subjekti i ka kategorizuar me rrezik të lartë apo nëse gjatë një transaksioni apo marrëdhënieje biznesi identifikohen rreziqe të larta që nuk janë evidentuar më parë.



9. Subjektet duhet t'u kushtojnë vigjilencë të zgjeruar marrëdhënieve të biznesit dhe transaksioneve me klientë për të cilët autoriteti përgjegjës kërkon që ky proces të kryhet.

10. Të dhënat, analizat, informacioni dhe dokumentacioni i mbledhur në zbatim të këtij neni ruhet për një periudhë pesëvjeçare.

Neni 11

Dokumentacioni i kërkuar për identifikimin e klientit

1. Për identifikimin dhe verifikimin e identitetit të klientit, subjektet duhet të regjistrojnë e të mbajnë të dhënat si më poshtë:

a) **për individët**: emrin, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen, shtetësinë, vendbanimin e përkohshëm (nëse ka) dhe të përhershëm, punësimin, llojin dhe numrin e dokumentit të identifikimit, numrin personal për shtetasit e Republikës së Shqipërisë, si dhe atë të barasvlershëm për shtetasit e huaj, autoritetin që e ka lëshuar, si dhe të gjitha ndryshimet e bëra në çastin e kryerjes së transaksionit.

b) **për personat fizikë**, që zhvillojnë veprimtari fitimprurëse: emrin, mbiemrin, datën e vendimit të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, dokumentin që vërteton objektin e veprimtarisë, numrin unik të identifikimit të subjektit, adresën dhe të gjitha ndryshimet e bëra në çastin e kryerjes së transaksionit;

c) **për personat juridikë privatë**, që zhvillojnë veprimtari fitimprurëse: emrin, datën e vendimit të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, dokumentin që vërteton objektin e veprimtarisë, numrin unik të identifikimit të subjektit, adresën e zyrës qendrore të regjistruar dhe, nëse është e ndryshme, edhe vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë, si dhe të gjitha ndryshimet e bëra në çastin e kryerjes së transaksionit;

ç) **për personat juridikë privatë (Organizata Jo-Fitim Prurëse)**, që nuk zhvillojnë veprimtari fitimprurëse: emrin, numrin dhe datën e vendimit të gjykatës për regjistrimin si person juridik, statutin dhe aktin e themelimit, numrin unik të identifikimit të subjektit, selinë e përhershme dhe, nëse është e ndryshme, edhe vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë, natyrën e veprimtarisë, përfaqësuesit ligjorë, si dhe personat që mbajnë pozicion drejtues vendimmarrës;

d) **për përfaqësuesit ligjorë** ose me prokurë të klientit: emrin, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen, shtetësinë, vendbanimin e përkohshëm (nëse ka) dhe të përhershëm, punësimin, llojin dhe numrin e dokumentit të identifikimit, numrin personal për shtetasit e Republikës së Shqipërisë, si dhe atë të barasvlershëm për shtetasit e huaj, autoritetin që e ka lëshuar dhe kopjen e aktit të përfaqësimit.

dh) **për organizimet ligjore**: identifikimin e themeluesit, të përfituesit, të kujdestarit ose të personit që ushtron kontroll faktik mbi to, sipas të dhënave të parashikuara në shkronjat e mësipërme, në varësi të faktit nëse është person fizik ose person juridik privat.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

2. Subjektet pranojnë nga klienti për të marrë të dhëna për të, sipas përcaktimeve të këtij neni, vetëm dokumente origjinale ose fotokopje të noterizuara ose dokument elektronik që plotëson kushtet e vlefshmërisë, sipas legjislacionit në fuqi për dokumentin elektronik ose nënshkrimin elektronik. Për qëllime të këtij ligji, subjekti mban në dosjen e klientit kopje të vulosura me vulën e subjektit, të dokumenteve të paraqitura nga klienti në formën e mësipërme, brenda afatit të vlefshmërisë së tyre.

3. Subjektet, kur e gjykojnë të nevojshme, duhet të kërkojnë paraqitjen nga klienti të dokumenteve të tjera identifikuese për verifikimin e të dhënave të paraqitura prej këtij të fundit.

Neni 12

Regjistrimi dhe ruajtja e të dhënave

Subjektet regjistrojnë në bazën e tyre të të dhënave çdo informacion që ka lidhje me identifikimin e klientit dhe për çdo transaksion financiar të kryer në emër ose për llogari të tij. Ruajtja e këtij informacioni, së bashku me dokumentacionin mbështetës, kryhet sipas kërkesave dhe afateve të përcaktuara në nenin 16, të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave.

Neni 13

Strukturat përgjegjëse të subjekteve

1. Subjektet krijojnë strukturën/at dhe infrastrukturën e nevojshme në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

2. Subjektet caktojnë një person përgjegjës në nivel administrimi/ drejtimi në zyrën qendrore për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Personi përgjegjës ka akses të vazhdueshëm ndaj të gjitha të dhënave dhe në çdo lloj informacioni që disponohet nga subjekti, i cili është i nevojshëm për përmbushjen e detyrave.

3. Strukturat përkatëse të subjektit vënë në dispozicion të personit përgjegjës, të caktuar sipas pikës 2 të këtij neni, mjetet dhe burimet e mjaftueshme për përmbushjen e funksionit të tij (si për shembull teknikën e përshtatshme, personelin e mjaftueshëm, një buxhet të arsyeshëm etj.), si dhe përgatisin një program trajnimi të vazhdueshëm për personin përgjegjës)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

4. Subjektet njoftojnë autoritetin mbikëqyrës për emrin e personit përgjegjës të caktuar sipas pikës 2 të këtij neni, si dhe në të gjitha rastet që ka ndryshime të këtij personi.
5. Subjektet i vënë në dispozicion autoritetit mbikëqyrës, menjëherë pas miratimit të tyre, kopje të procedurave të brendshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit të parashikuara në dispozitat e kësaj rregulloreje.
6. Subjektet hartojnë dhe miratojnë rregullore/procedura për kategorizimin e klientëve dhe transaksioneve sipas shkallës së rrezikut që ato paraqesin, në përputhje me nenet 8 të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave.
7. Procedurat që kryhen sipas të kësaj rregulloreje, janë pjesë e procedurave që kryhen nga subjektet e mbikëqyrura gjatë kryerjes së shërbimit të auditimit ligjor, shërbimeve të kontabilitetit, shërbimeve të tjera të dhënies së sigurisë dhe shërbimeve të tjera që parashikohen nga dispozitat e ligjit nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.
8. Subjektet e kësaj rregulloreje që veprojnë në Republikën e Shqipërisë kryejnë dhe dokumentojnë procedurat e auditimit në përputhje me SNA240, SNA250 dhe SNA315, si edhe regjistrojnë transaksionet e çdo klienti apo grupe financiare në lidhje me secilën prej degëve dhe degëve të tyre të vendosura në vendet e treta me rrezik të lartë.
9. Subjektet sigurohen se filialet apo degët jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe në veçanti në vendet dhe territoret të cilat nuk zbatojnë apo zbatojnë pjesërisht standardet ndërkombëtare, veprojnë në përputhje me masat parandaluese të parashikuara në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave. Nëse ligjet e vendit ku janë vendosur filialet apo degët parashikojnë pengesa për zbatimin e detyrimeve, subjekti duhet të raportojë për këto pengesa tek autoriteti përgjegjës (DPPPP) dhe sipas rastit dhe në autoritetin mbikëqyrës.
10. Personat përgjegjës të subjekteve, të caktuar sipas pikës 2 të këtij neni, hartojnë dhe zbatojnë një program vjetor të trajnimit të punonjësve të subjekteve, lidhur me rregulloret dhe procedurat e brendshme të miratuara për qëllim të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
11. Personat përgjegjës të subjekteve, të caktuar sipas pikës 2 të këtij neni, informojnë periodikisht punonjësit e këtyre të fundit lidhur me ndryshimin e dispozitave ligjore në fuqi për parandalimin dhe dënimin e veprave penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe për detyrimet e tyre lidhur me zbatimin e këtyre ndryshimeve.
12. Subjektet kryejnë monitorime të vazhdueshme të marrëdhënieve të biznesit me klientët e tyre, për t’u siguruar se ata kanë njohuri për klientin, për objektin e veprimtarisë së tij.
13. Punonjësit e subjekteve ruajnë konfidencialitetin për procesin e raportimit lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit dhe ndalohen të njoftojnë klientin



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

për procedurat e verifikimit të dyshimeve dhe për raportimin e bërë tek autoriteti përgjegjës (DPPPP).

Neni 14

Raportimi tek autoriteti përgjegjës (DPPPP)

1. Subjektet i raportojnë autoritetit përgjegjës sipas formularëve të raportimit dhe afateve të përcaktuara me akt nënligjor nga autoriteti përgjegjës për të gjitha transaksionet në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 000 000 (një milion) lekë ose kundërvlerën në monedha të tjera të huaja;
2. Subjektet, kanë arsye të besojnë ose të dyshojnë se transaksioni i kërkuar për t'u kryer nga një klient apo një person tjetër për llogari të klientit, mund të përfshijë pastrim të produkteve të veprës penale, financim terrorizmi apo fonde që rrjedhin nga veprimtari kriminale, ia raportojnë menjëherë çështjen autoritetit përgjegjës dhe vënë në dijeni autoritetin mbikëqyrës. Në këto raste, subjektet presin deri në 48 (dyzetë e tetë) orë pas raportimit në autoritetin përgjegjës për udhëzimet e këtij të fundit, nëse duhet ta kryejnë apo jo transaksionin.
3. Subjektet i paraqesin një raport autoritetit përgjegjës, ku parashtrojnë dyshimet që kanë për rastet kur e dinë apo dyshojnë se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të vepërs penale, financimi i terrorizmit apo fondet e përfshira rrjedhin nga veprimtari kriminale. Raportimi bëhet menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë.

Kreu III

Dispozita të fundit

Neni 15

Kërkesat mbikëqyrëse

1. Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) mbikëqyr nëpërmjet inspektimeve tematike zbatimin e dispozitave të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave, të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe kërkesave të kësaj rregulloreje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

2. Bordi i Mbikëqyrjes Publike harton dhe miraton manuale, si pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje, për mbikëqyrjen e subjekteve për zbatimin e kësaj rregulloreje.
3. Bordi i Mbikëqyrjes Publike harton udhëzuesin për matjen e rrezikut nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit në ndihmë të subjekteve për zbatimin e kësaj rregulloreje.
4. Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) raporton tek autoriteti përgjegjës, çdo dyshim, informacion ose të dhënë, në përfundim të procesit të inspektimit ose të investigimit, që vlerëson se mund të lidhet me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, për veprimtaritë nën juridiksionin dhe mbikëqyrjen e tyre
5. Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) vlerëson mjaftueshmërinë e programeve dhe të sistemit të kontrollit të brendshëm të subjektit, në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
6. Të gjitha shkeljet e kësaj rregulloreje do të jenë subjekt i masave disiplinore nga BMP si pas parashikimeve të nenit 55 të ligjit nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar dhe rregullores nr.4 datë 29.03.2018 “Për investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore”, i ndryshuar.
7. Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP), përveç parashikimeve të pikës 6 të këtij neni, për të gjitha shkeljet e evidentuara të cilat mund të klasifikohen si kundravajtje administrative, në bazë të nenit 27 të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave, dhe nenit 7 germës b), pika 3 e Ligjit nr. 157, datë 10.10.2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit, informon autoritetin përgjegjës duke i vënë në dispozicion dokumentacionin e plotë që ka lidhje me konstatimin e shkelje dhe bashkëpunon me të.
8. Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) kërkon nga subjektet akses dhe vënien në dispozicion të çdo lloj informacioni dhe dokumenti që lidhet me përputhshmërinë e detyrimeve të subjekteve në zbatim të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave.

Neni 16

Dispozita të tjera

Subjektet e kësaj rregulloreje, jo më vonë se 3 (tre) muaj pas hyrjes në fuqi të saj, janë të detyruara të kryejnë në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje rishikimin dhe/ose miratimin, e rregulloreve dhe procedurave të brendshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Neni 17

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

UDHËZUES

**PËR MATJEN E RREZIKUT NGA PASTRIMI I PARAVE DHE FINANCIMI I
TERRORIZMIT**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Profesionistët kontabël¹ shërbejnë si një komponent kyç në sistemin financiar dhe në transaksionet jetësore që mbështesin ekonominë. Si të tillë, luajnë një rol të rëndësishëm për të siguruar që shërbimet e tyre të mos përdoren për qëllime kriminale. Si profesionistë, audituesit ligjorë dhe kontabilistët e miratuar duhet të veprojnë me integritet dhe të respektojnë ligjin, dhe ata nuk duhet të përfshihen në veprimtari kriminale. Ky udhëzim bazohet në kuadrin ligjor dhe rregullator të përditësuar në Qershor 2020. Ai përfshin parandalimin e pastrimit të parave dhe kundërveprimin e financimit të terrorizmit. Ky udhëzim duhet të lexohet nga profesionistët që ofrojnë shërbime të auditimit dhe rishikimit, të kontabilitetit, të konsulencës fiskale, të likuidimit dhe falimentimit si edhe nga organizatat profesionale të audituesve ligjorë dhe kontabilistëve të miratuar. Ky udhëzim është miratuar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike në cilësinë e autoritetit mbikëqyrës në Republikën e Shqipërisë. Qëllimi i këtij udhëzuesi është të ndihmojë subjektet e rregullores “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” (në vijim referuar si PPP/FT), në administrimin e rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Udhëzuesi nuk zëvendëson detyrimet ligjore të subjekteve, por synon t’i ndihmojë ato për të kuptuar dhe administruar rreziqet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP), nëpërmjet këtij udhëzuesi, ofron një qasje të bazuar në rrezik në bazë të standardeve më të mira ndërkombëtare për administrimin efektiv të rreziqeve që vijnë nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit. Në këtë kuadër, BMP inkurajon subjektet që të zhvillojnë praktika apo procedura për të vlerësuar dhe parandaluar kryerjen e veprimeve të cilat përdoren për pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit.

Udhëzuesi është i destinuar të përdoret nga subjektet e mbikëqyrura nga BMP, drejtuesit dhe stafin e tyre. Udhëzuesi ka qëllim të ofrojë një sfond të përgjithshëm mbi subjektet e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit (PP/FT), duke përfshirë një përmbledhje të dispozitave kryesore të parandalimit të pastrimit të parave dhe luftës kundra financimit të terrorizmit (PPP/LFT) në Shqipëri; si dhe të ofrojë udhëzime praktike për të ndihmuar audituesit ligjorë, kontabilistët e miratuar (subjektet e mbikëqyrura) dhe drejtuesit e tyre të lartë në hartimin dhe zbatimin e politikave, procedurave dhe kontrolleve të tyre në zonat përkatëse operacionale, duke marrë parasysh ato rrethana të veçanta në mënyrë që të plotësojnë ligjet përkatëse dhe kërkesat rregullatore të PPP /LFT.

Kuadri ligjor dhe rregullator për PPP/FT

- Ligji nr. 9917 datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar,
- Ligji nr.157/2013 “Për masat e marra kundër financimit të terrorizmit”, i ndryshuar.
- Udhëzim nr. 29, datë 31.12.2012 “Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të profesioneve të lira jofinanciare”

¹ Termi profesionistët kontabël i referohet personave që ushtrojnë profesionin e audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar sipas dispozitave të ligjit 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

- Ligj nr. 72/2019 “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”

“Pastrim i produkteve të veprës penale” ka të njëjtin kuptim si në nenin 287 të Kodit Penal.

Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, nëpërmjet:

a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

ç) kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave;

d) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale;

dh) këshillimit, ndihmës, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër

“Financim terrorizmi” ka të njëjtin kuptim si në nenin 230a të Kodit Penal.

(a) sigurimi ose grumbullimi, me çdo mjet, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të çdo prone:

(i) me qëllim që të përdoret prona; ose

(ii) duke ditur se prona do të përdoret, në tërësi ose pjesërisht, për të kryer një ose më shumë akte terroriste (pavarësisht nëse prona përdoret për raste të tilla);

(b) vënien në dispozicion e çdo pasurie ose shërbime financiare (të lidhura), me çfarëdo mjeti, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në dobi të një personi që e di, ose që nuk e di nga pakujdesia, se është terrorist ose bashkëpunëtor me terroristët;

(c) grumbullimin e pasurisë ose kërkimin e shërbimeve financiare (të lidhura) në çdo mënyrë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në dobi të një personi që e di, ose që nuk e di nga pakujdesia, se është terrorist ose bashkëpunëtor terrorist.

Terroristët ose organizatat terroriste kërkojnë mbështetje financiare për të arritur qëllimet e tyre. Shpeshherë është e nevojshme që ata të errësojnë ose fshehin lidhjet ndërmjet tyre dhe burimet e tyre të financimit. Më pas grupet terroriste duhet të gjejnë mënyra për të pastruar fondet,



pavarësisht nëse fondet vijnë nga një burim i ligjshëm ose i paligjshëm, në mënyrë që të jenë në gjendje t'i përdorin ato pa tërhequr vëmendjen e autoriteteve.

I. Përshkrim i përgjithshëm mbi matjen e rrezikut

Qasja e bazuar në rrezik është thelbësore për të kënaqur rekomandimet e FATF, direktivën e BE-së dhe kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator të PPP/FT në Shqipëri. Kjo qasje kërkon që qeveria, mbikëqyrësit dhe bizneset të analizojnë rreziqet e PPP/FT me të cilat përballen dhe të hartojnë përgjigje proporcionale ndaj tyre. Kjo përbën edhe themelin e politikave, kontrolleve dhe procedurave të PPP/FT të çdo biznesi, veçanërisht vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar ndaj klientit dhe procedurave të trajnimit të stafit.

Qasja e bazuar në rrezik pranon që kërcënimet nga veprimtaria e financimit të PP/FT nuk do të jenë të njëjta në çdo rast dhe kështu lejon biznesin të përshtatë reagimin e tij në përpjesëtim me perceptimet e tij të rrezikut. Qasja e bazuar në rrezik kërkon vendimmarrje të bazuar në prova për të shënjestruar më mirë rreziqet. Asnjë procedurë nuk do të zbulojë dhe parandalojë kurrë të gjitha PP/FT, por një analizë realiste e rreziqeve aktuale i mundëson një biznesi të përqendrojë burimet më të mëdha në kërcënimet më të mëdha.

Subjektet, së pari, identifikojnë rreziqet e mundshme të pastrimit të parave, me qëllim zbatimin e një sistemi efikas të matjes së rrezikut. Këto rreziqe mund të identifikohen në forma nga më të ndryshme, por kryesisht ato identifikohen në bazë të faktorëve të rrezikut.

Me faktorë rreziku do të kuptojmë bashkësinë/grupin e kategorive të klientëve, produkteve dhe shërbimeve/transaksioneve, si dhe zonës gjeografike të përcaktuar nga burime të besueshme informacioni si grup kategorish gjerësisht të pranuar për të vlerësuar rrezikun. Subjektet duhet të zbatojë sisteme adekuate dhe të përshtatshme të PPP / FT (duke përfshirë politikën dhe procedurat e pranimit të klientëve) duke marrë parasysh faktorët duke përfshirë produktet dhe shërbimet e ofruara, llojet e konsumatorëve, vendndodhjet gjeografike të përfshira.

Me burime të besueshme informacioni në këtë udhëzues, i referohemi informacionit publik, të vënë gjerësisht në dispozicion nga organe të njohura dhe me reputacion, si për shembull Organizata e Kombeve të Bashkuara, FATF, Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Këshilli i Evropës, OFAC, Grupi Egmont etj.

Drejtuesit e subjektit duhet të sigurojnë që vlerësimi i rrezikut dhe proceset për zbutjen e tij të kryhen në mënyrë profesionale, me qëllim përmbushjen e të gjitha detyrimeve ligjore në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe parandalimit të parave dhe çdo veprimi të paligjshëm, i cili synon pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Identifikimi i nivelit të rreziqeve të mundshme ndihmon subjektet për të marrë masat e duhura për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Identifikimi i rreziqeve fillon që në momentin e parë që klienti kërkon të hyjë në marrëdhënie biznesi me subjektin.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Në vazhdim, identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve do të bëhet më evident gjatë zhvillimit të marrëdhënies së biznesit.

Subjekti, pasi ka përcaktuar faktorët e rrezikut, bën përcaktimin e kategorive të faktorëve të rrezikut. Me kategori të faktorit të rrezikut do të kuptojmë llojet e klientëve si dhe llojet e produkteve dhe të shërbimeve që subjekti u ofron klientëve, llojet e transaksioneve si dhe zona gjeografike prej të cilës klientët janë (prejardhja/vendndodhja) ose kanë marrëdhënie biznesi.

Në vazhdim të procesit të identifikimit të rreziqeve të mundshme, pasi subjekti ka krijuar kategoritë e faktorëve, realizohet procesi i monitorimit të këtyre kategorive, i cili shërben si një nga proceset më të rëndësishme në matjen e rrezikut. Në vijim të procesit të monitorimit realizohet procesi i analizës. Megjithatë, vlerësohet se nuk ekziston një ndarje racionale e mirëfilltë midis procesit të monitorimit dhe procesit të analizës.

Të dyja këto procese, për shumë subjekte mund të nënkuptojnë ndërmarrjen e masave të njëjta, por për efekt të këtij udhëzimi do të pranojmë se “analiza” është pjesë e procesit të monitorimit dhe përfshin masat më të përforcuara të tij, duke ruajtur të dhëna / konkluzione me shkrim, të cilat i paraqiten autoriteteve kompetente. Analizimi i transaksioneve përbën bazën e ngritjes së sistemit të PPP/LFT nga subjektet sepse është produkti (output-i) i të gjithë këtij procesi.

Analizimi i kategorive të faktorëve të rrezikut shërben për të gjykuar rreth përputhshmërisë së profilit të klientit me profilin e transaksioneve, si dhe destinacionin e fondeve.

Identifikimi i faktorëve të rrezikut si dhe kategorive të faktorëve lejon zbatimin e një përjasje të bazuar në rrezik. Kjo qasje e bazuar në rrezik, mundëson strukturat e subjektit të përqendrohen në çështje, të cilat mbartin ekspozim më të madh ndaj rrezikut. Subjekti duhet të vlerësojë kapacitetet e tij për të ndërtuar një përjasje të tillë, duke identifikuar dhe vlerësuar “mundësitë”, “dobësitë”, “rreziqet”, si dhe “fuqitë” e tij për të përfituar nga kjo metodologji.

Procesi i vlerësimit të rrezikut PPP/FT ka katër faza :

- 1) identifikimin e proceseve dhe transaksioneve biznesit të ekspozuara ndaj PPP/FT;
- 2) kryerja e një analize për të vlerësuar probabilitetin dhe ndikimin e PPP/FT;
- 3) administrimi i rreziqeve; dhe
- 4) monitorimin dhe rishikimin e rreziqeve.

Faza e parë e vlerësimit të rrezikut është të identifikojë klientët, produktet, shërbimet, transaksionet dhe vendet gjeografike specifike për njësinë ekonomike. Në varësi të karakteristikave specifike dhe kanaleve të ofrimit të klientëve, produkteve, shërbimeve dhe transaksioneve të caktuara, kërcënimi dhe prekshmëria ndaj pastrimit të parave dhe financimi i terrorizmit ndryshon.

Në fazën e dytë, rreziqet e PPP/FT që mund të hasen në një njësi ekonomike duhet të analizohen si një kombinim i probabilitetit që rreziqet të ndodhin dhe ndikimi i kostos ose dëmtimeve nëse ndodhin rreziqet. Ky ndikim mund të konsistojë në humbje financiare të biznesit nga krimi, nga



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

gjobat nga autoritetet ose nga masat e përmirësuara të zbutjes. Ai gjithashtu mund të përbëhet nga dëme në reputacion të biznesit ose të gjithë sektorit. Analiza e kategorive të caktuara të rrezikut dhe kombinimet e tyre është specifike për secilin entitet, kështu që përfundimi në nivelin e përgjithshëm të rrezikut duhet të bazohet në të gjitha informacionet përkatëse.

Në fazën e tretë, subjekti do të bazojë në analizë strategjitet e administrimit të rrezikut dhe do të zbatojë politikat dhe procedurat në përputhje me rrethanat. Për të zbutur në mënyrë efektive rrezikun, do të zbatohen sisteme dhe kontrole të përshtatshme. Këto sisteme kontrollit duhet të jenë të miratuara nga drejtimi i subjektit.

Së fundmi, në këtë proces rreziqet dhe administrimi i rreziqeve duhet të monitorohen dhe rishikohen. Një subjekt mund ta bëjë këtë duke zhvilluar një regjim monitorimi përmes pajtueshmërisë dhe programeve të tij të sistemit të brendshëm të kontrollit. Vlerësimi i rreziqeve PPP/FT duhet të rishikohet në mënyrë periodike, bazuar në masën që rreziqet kanë ndryshuar ose operacionet ose strategjitet e njësive ekonomike kanë ndryshuar.


Në rastet kur subjektet identifikojnë ekspozim të lartë ndaj rrezikut, aplikojnë masa të përforcuara për administrimin dhe zbutjen e ekspozimit ndaj rreziqeve.

Duke pasur parasysh faktin se natyra e financimit të terrorizmit ndryshon nga ajo e pastrimit të parave, vlerësimi i rrezikut duhet të përfshijë gjithashtu një analizë të dobësive të financimit të terrorizmit. Meqenëse fondet e përdorura për financimin e terrorizmit mund të rrjedhin nga burimet ligjore, natyra e burimeve mund të ndryshojë. Kur burimet e financimit të terrorizmit burojnë nga aktivitetet kriminale, vlerësimi i rrezikut në lidhje me pastrimin e parave është gjithashtu i zbatueshëm për financimin e terrorizmit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE


Në mënyrë të përmblledhur ky proces paraqitet sipas skemës së mëposhtme:



II. Niveli i rrezikut

Subjektet identifikojnë rrezikun, duke kryer vlerësime ose matje në dy drejtime kryesore:

- në ndikimin (dëmin) që mund të shkaktohet, në rast se ndodh një ngjarje, e cila është shoqëruar ose ka shkaktuar pastrim parash apo financim të terrorizmit; dhe
- në mundësinë e realizimit të ngjarjes, e cila mund të shoqërohet ose shkaktojë pastrim parash apo financim të terrorizmit.



Subjektet, në varësi të vlerësimit të mundësisë apo pasojave që mund të sjellë kryerja e një ngjarjeje, e cila çon në pastrim parash apo financim të terrorizmit, mund të kryejnë vlerësimin e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

rrezikut në këndvështrime të ndryshme. Pavarësisht kësaj, gjykohet se në përputhje me kuadrin ligjor, dy janë nivelet e kategorizimit të rrezikut:

- Niveli i ulët dhe niveli i mesëm ose i moderuar i rrezikut - kur mundësia që të ndodhë pastrim parash dhe financim terrorizmi është e vogël dhe/ose të ketë pasoja të vogla ose të papërfillshme për subjektin. Në këto raste, zbatohen gjithmonë masat e vigjilencës së thjeshtuar apo vigjilencës së duhur të parashikuar në këtë rregullore si edhe në ligj apo aktet nënligjore.

- Niveli i lartë i rrezikut - kur ekziston mundësia që të ndodhë pastrim parash dhe financim terrorizmi dhe/ose të ketë pasoja, të cilat mund të konsiderohen të dëmshme ose shumë serioze për subjektin. Në këto raste, zbatohen gjithmonë masat e vigjilencës së zgjeruar të parashikuar në këtë rregullore si edhe në ligj apo aktet nënligjore.

Megjithatë, subjektet nga ana e tyre mund të përdorin një përjasje të tillë, e cila e kategorizon rrezikun në tre nivele: niveli i ulët, i mesëm dhe i lartë, por niveli me rrezik të ulët dhe niveli me rrezik të mesëm duhet të kanalizohen në kategorinë e vigjilencës së thjeshtuar dhe vigjilencës së duhur.

Dobësitë e profesionistit kontabël

Disa prej shërbimeve të ofruara nga profesionistët kontabël të cilat synohen nga pastruesi i parave i mundshëm janë:

a) Konsulenca financiare dhe tatimore - kriminelët mund të paraqesin si individë që kërkojnë konsulencë financiare ose tatimore për të vendosur pasuritë jashtë mundësive për të shmangur detyrimet në të ardhmen.

b) Themelimi i shoqërive apo të trusteve - kriminelët mund të përpiqen të ngatërrojnë ose maskojnë lidhjet midis të ardhurave të një krimi dhe autorit të krimit përmes formimit të shoqërive si mjet apo marrëveshjeve të tjera ligjore komplekse (trustet, për shembull).

c) Blerja ose shitja e pasurisë - kriminelët mund të përdorin transferimin e pronave për të shërbyer si mbulesë për transferimet e fondeve të paligjshme (faza e vendosjes) ose përndryshe investimi përfundimtar i këtyre të ardhurave pasi të kenë kaluar në procesin e pastrimit (faza e përfshirjes).

d) Kryerja e transaksioneve financiare - kriminelët mund të përdorin profesionistët kontabël për të kryer ose lehtësuar operacione të ndryshme financiare në emër të tyre (p.sh. depozitat në para ose tërheqjet në llogari, veprimet me pakicë të këmbimit valutor, lëshimin dhe kontrollimin e parave të gatshme, blerjen dhe shitjen e aksioneve, dërgimin dhe marrjen ndërkombëtare) transferime fondesh, etj).

e) Ndërmjetësimi në prezantimin njohës me institucionet financiare - kriminelët mund të përdorin profesionistët kontabël si prezantues ose ndërmjetës. Kjo mund të jetë e dyanshme pasi kriminelët mund të përdorin institucionet financiare për të mundësuar njohjen me profesionistët kontabël gjithashtu.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

f) Mbajtja e regjistrave jo të plotë nga klientët siç zbulohet gjatë shërbimeve të kontabilitetit të ofruara mund të jetë një zonë me rrezik më të lartë. Gjithashtu, përgatitja, rishikimi dhe auditimi i pasqyrave financiare mund të jenë të ndjeshme për keqpërdorim nga kriminelët kur ka mungesë të mbikëqyrjes së trupit profesional ose zbatimit të duhur të standardeve të kontabilitetit dhe auditimit.

g) Kriminelët mund të kërkojnë mundësinë për të mbajtur kontrollin mbi pasuritë e fituara nga aktiviteti kriminal duke ulur mundësitë e forcës së ligjit për të gjurmuar origjinën dhe pronësinë e pasurive. Shoqëritë dhe trustet dhe organizimet e tjera të ngjashme ligjore shihen nga kriminelët si mjete potencialisht të dobishme për të arritur këtë përfundim. Ndërsa shoqëritë guackë, të cilat nuk kanë aktive apo aktivitet biznesi në vazhdim, mund të përdoren për qëllime të ligjshme, si përshebull të shërbejnë si mjet për kryerjen e transaksionit, ato mund të përdoren gjithashtu për të fshehur pronarin e fundit përfitues, ose për të rritur perceptimin e legjitimitetit. Kriminelët gjithashtu mund të kërkojnë të keqpërdorin shoqëritë fiktive në letra, të cilat mund të themelohen nga profesionistët kontabël, duke kërkuar akses në shoqëri të cilat ekzistojnë vetëm në letra për një kohë të gjatë. Kjo mund të jetë në një përpjekje për të krijuar përshtypjen se kompania është me reputacion dhe po vepron sipas veprimtarisë normale të biznesit prej shumë vitesh. Shoqëritë fiktive shtojnë kompleksitetin e strukturave të shoqërive me qëllimin për të fshehur pronarin e fundit përfitues.

h) Menaxhimi i shoqërive dhe trusteve - Në disa raste, kriminelët mund të kërkojnë shërbimin e profesionistëve kontabël të përfshirë në administrimin e shoqërive dhe trusteve në mënyrë që të sigurojnë një respekt më të madh dhe ligjshmëri për shoqërinë apo trustin dhe aktivitetet e saj. Në disa vende, kërkesat rregullore ndalojnë që një profesionist kontabël të veprojnë në emër apo si administrator/drejtor i një shoqërie, ose të kërkojë një zbulim të pozitive të drejtorisë për të siguruar pavarësinë duke ruajtur transparencën. Kjo do të ndikojë nëse fondet që lidhen me aktivitetet e shoqërisë ose trustit mund të kalojnë nëpërmjet llogarisë përkatëse të klientit të kontabilistit përkatës.

i) Veprimet në emër dhe për llogari të të tretëve - Profesionistëve kontabël apo individëve të tjerë, mund t'u kërkohej që të mbajnë kuotat e pronësisë si "përfaqësues" në marrëveshje ku ruhet fshehtësia dhe siguria e të dhënave të pronarëve të vërtetë. Sidoqoftë, kriminelët gjithashtu mund të përdorin aksionerët e nominuar për të fshehur pronësinë e tyre mbi pasuritë. Në disa vende, profesionistët kontabël nuk lejohen të mbajnë kuota/aksione në njësi ekonomike për të cilët ofrojnë shërbime konsulence, kontabiliteti, auditimi, ndërsa në vendet e tjera profesionistët kontabël veprojnë rregullisht si përfaqësues. Profesionistët kontabël duhet të identifikojnë pronarët përfitues kur vendosin marrëdhënie biznesi në këto situata. Kjo është e rëndësishme për të parandaluar përdorimin e paligjshëm të personave juridikë dhe marrëveshjeve ligjore, duke fituar një njohje të mjaftueshme të klientit për të qenë në gjendje të vlerësojë dhe zbusë siç duhet rreziqet e mundshme PPP/FT të lidhura me marrëdhëniet e biznesit. Në rastet kur profesionistëve kontabël u kërkohej të veprojnë si përfaqësues, ata duhet të kuptojnë arsyen e kësaj kërkesë dhe të sigurojnë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

që ata janë në gjendje të verifikojnë identitetin e pronarit përfitues të kuotave/aksioneve dhe se qëllimi duket se është i ligjshëm.

j) Shërbime të kontabilitetit për falsifikimin e regjistrimeve kontabël të falsifikuara dhe evazion tatimor, keqpërdorim të llogarive të klientit dhe shërbimet e falimentimit - Kriminelët mund të keqpërdorin shërbimet e ofruara nga profesionistët kontabël për të legjitimuar regjistrimet kontabël të falsifikuara në mënyrë që të fshehin burimin e fondeve. Për shembull, profesionistët kontabël mund të rishikojnë dhe nënshkruajnë të tilla pasqyra financiare apo regjistrime kontabël për bizneset e përfshira në kriminalitet, duke lehtësuar kështu pastrimin e parave.

Profesionistët kontabël gjithashtu mund të kryejnë transaksione financiare me vlerë të lartë duke lejuar kriminelët të keqpërdorin llogaritë e klientëve të kontabilistëve. Procedurat e falimentit, e cila mund të bëhet nga disa profesionistë të kontabilitetit gjithashtu paraqet rrezik që kriminelët të fshehin gjurmët e auditimit të parave të pastruara përmes një kompanie dhe të transferojnë të ardhurat e krimit. Shërbimet e kontabilitetit mund të përdoren gjithashtu për të lehtësuar evazionin tatimor dhe mashtrimin me TVSH-në.

Megjithatë profesionistët kontabël nuk janë të detyruar të shmangin plotësisht rrezikun. Edhe nëse shërbimet që ata ofrojnë për klientët e tyre konsiderohen të prekshëm ndaj rreziqeve të PPP/FT bazuar në vlerësimin e rrezikut, nuk do të thotë që të gjithë profesionistët kontabël dhe të gjithë klientët ose shërbimet e tyre paraqesin një rrezik më të lartë, kur merren parasysh masat e marra prej tyre për të zbutur këtë rrezik.

III. Identifikimi dhe vlerësimi i rrezikut

Subjektet e kësaj rregulloreje duhet të ndërmarrin hapa të duhur për të identifikuar dhe vlerësuar rrezikun në mënyrë të plotë, duke pasur parasysh natyrën e klientëve të tyre, që ato mund të përdoren për PP/FT. Kjo zakonisht kryhet si pjesë e procesit të përgjithshëm të pranimit të klientit dhe angazhimit. Ata duhet të dokumentojnë ato vlerësime, t'i mbajnë të përditësuara këto vlerësime dhe të kenë mekanizma të duhur për të siguruar informacione për vlerësimin e rrezikut autoritetit përgjegjës dhe mbikëqyrësve. Natyra dhe shtrirja e çdo vlerësimi të rreziqeve të PP/FT duhet të jetë e përshtatshme me llojin e biznesit, natyrën e klientëve dhe madhësisë së transaksioneve të biznesit.

Rreziqet e PP/FT mund të renditen në tre kategori: (a) rreziku i vendit / gjeografik, (b) rreziku i klientit dhe (c) rreziku i transaksionit / shërbimit dhe rreziku i kanalit të ofrimit të shërbimit. Rreziqet dhe sinjalet e renditura në secilën kategori nuk janë shteruese, por ofrojnë një qasje për subjektet gjatë zbatimit të analizës dhe vlerësimit të rreziqeve të PP/FT.

Gjatë vlerësimit të rrezikut, profesionistët kontabël duhet të marrin parasysh të gjithë faktorët përkatës të rrezikut përpara se të përcaktojnë nivelin e rrezikut të përgjithshëm dhe nivelin e duhur të zbutjes që do të zbatohet. Një vlerësim i tillë i rrezikut mund të informohet nga gjetjet e vlerësimit kombëtar të rrezikut, vlerësimet kombëtare të rrezikut, raportet sektoriale të kryera nga autoritetet përgjegjëse mbi rreziqet e PPP/FT që janë të natyrshme në shërbimet / sektorin e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

kontabilitetit, raportet e rrezikut në juridiksione të tjera ku profesionisti kontabël mund të bazohet dhe çdo informacion tjetër që mund të jetë i rëndësishëm për të vlerësuar nivelin e rrezikut të veçantë për praktikën e tyre.

Për shembull, artikujt e shtypit dhe informacione të tjera publike në dispozicion të gjerë që theksojnë çështje që mund të jenë shfaqur në juridiksione të veçanta. Profesionistët kontabël gjithashtu mund të mbështeten në udhëzimet e FATF mbi treguesit dhe faktorët e rrezikut. Gjatë marrëdhënies me klientin, procedurat për monitorimin e vazhdueshëm dhe rishikimin e profilit të rrezikut të klientit janë gjithashtu të rëndësishme. Autoritetet duhet të marrin në konsideratë se si ata mund të sinjalizojnë profesionistët kontabël mbi gjetjet e vlerësimit kombëtar të rrezikut dhe çdo informacion tjetër që mund të jetë i rëndësishëm për të vlerësuar nivelin e rrezikut të veçantë për një praktikë kontabël në vend.

Identifikimi i rreziqeve të PP/FT që i atribuohet klientëve të caktuar ose kategori klientësh, dhe lloje të caktuara të shërbimeve do t'i lejojnë subjektet të përcaktojnë dhe zbatojnë masa dhe kontrole të arsyeshme dhe proporcionale për të lehtësuar të tilla rreziqe. Rreziqet dhe masat e duhura do të varen nga natyra e rolit dhe përfshirjes së subjektit. Rrethanat mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme midis profesionistëve që përfaqësojnë klientë në një transaksion të vetëm dhe atyre që janë të përfshirë në një marrëdhënie afatgjatë konsulence.

Niveli i monitorimit dhe rishikimit të vazhdueshëm do të varet nga natyra dhe shpeshësia e marrëdhënies, së bashku me vlerësimin gjithëpërfshirës të rrezikut të klientit / transaksionit. Një auditues/kontabilist gjithashtu mund të duhet të rregullojë vlerësimin e rrezikut të një klienti të veçantë bazuar në informacionin e marrë nga një autoritet i caktuar kompetent, autoritet mbikëqyrës apo burime të tjera të besueshme (përfshirë një koleg).

Subjektet mund të vlerësojnë rreziqet e PP/FT duke u bazuar në kategori të ndryshme. Kjo siguron një strategji për administrimin e rreziqeve të mundshme duke u mundësuar, kur është e kërkueshme, që ta zbatojnë për çdo klient një vlerësim rreziku të arsyeshëm dhe proporcional. Pësha e dhënë këtyre kategorive të rrezikut (individualisht ose në kombinim) në vlerësimin e rrezikut të përgjithshëm të PP/FT të mundshme mund të ndryshojë duke pasur parasysh madhësinë, kompleksitetin, natyrën dhe fushën e shërbimeve të ofruara nga subjekti dhe / ose shoqëria. Sidoqoftë, këto kritere duhet të konsiderohen së bashku dhe jo të veçuar. Subjektet, bazuar në praktikën e tyre individuale dhe gjykimet e arsyeshme, do të duhet të vlerësojnë në mënyrë të pavarur peshën që do t'i jepet secilit faktor rreziku.

Megjithëse nuk ka një grup kategorish të rreziqeve të pranuar në mënyrë universale, shembujt e dhënë në këtë Udhëzim janë kategoritë e identifikuar më shpesh nga rreziku. Nuk ka asnjë metodologji të vetme për të zbatuar këto kategori rreziku, dhe zbatimi i këtyre kategorive të rrezikut ka për qëllim të sigurojë një kuadër të sugjeruar për afrimin e vlerësimit dhe menaxhimit të rreziqeve të mundshme PP/ FT. Për firmat më të vogla dhe praktikuesit e vetëm, këshillohet të shikohen shërbimet që ata ofrojnë (p.sh. ofrimi i shërbimeve të menaxhimit të klientëve mund të përbëjë rrezik më të madh se shërbimet e tjera).




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Një pikë nisje për shoqëritë e auditimit/kontabilitetit (në veçanti shoqëritë e vogla apo praktikuesit e vetëm) do të ishte zbatimi i qasjes si në vijim. Shumë nga këta elementë janë thelbësorë për përmbushjen e detyrimeve të tjera që kryhen ndaj klientëve, siç janë detyrat e besimit, dhe si pjesë e detyrimeve të tyre rregullatore të përgjithshme:

- a) Pranimi i klientit dhe politikat "njih klientin tënd": të identifikohet klienti (dhe pronarët e tij përfitues aty ku është e zbatueshme) dhe "përfituesit" e vërtetë të transaksionit. Të fitohet një kuptueshmëri e burimit të fondeve dhe burimit të pasurisë së klientit, pronarëve të tij dhe qëllimit të transaksionit. Një shëmbull për identifikimin e pronarit përfitues paraqitet si më poshtë:

Shëmbull ilustrues - Përcaktimi i pronarëve përfitues në rastet e strukturave komplekse të pronësisë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Klienti është Shoqëria A, një shoqëri private. Nëse personat F ose G nuk ushtrojnë kontrollin përkatës përmes mjeteve të tjera (të tilla si përmes 25% të të drejtave të votimit ose mjeteve të tjera të kontrollit) dhe bazuar në një prag të pronësisë 25%, pronarët përfitues janë personi D dhe personi E.

Në përcaktimin e pronarëve përfitues, duhet të kuptohet pronësia e shoqërive B dhe C (gjithashtu shoqëri private), por ato vetë nuk plotësojnë përkufizimin e një pronari përfitues, pasi ato nuk janë individë.

Personi D: identifikohet si pronar përfitues për shkak të përqindjes indirekte të kuotës prej 30% që zotëron në shoqërinë A përmes kuotave që zotëron në shoqërinë B.

Personi E: identifikohet si pronar përfitues për shkak të përqindjes indirekte të kuotës prej 30% që zotëron në shoqërinë A nëpërmjet kuotave që zotëron në shoqërinë B dhe C. Personat F&G nuk janë pronarë përfitues pasi zotërojnë vetëm 20% të kuotave të shoqërisë A nëpërmjet zotërimit të kuotave në shoqërinë C.

- b) Politikat e pranimit/vazhdimin të angazhimit/klientit: Të kuptohet natyra e punës. Subjektet duhet të njohin natyrën e saktë të shërbimit që ata ofrojnë dhe të kenë një kuptueshmëri se si shërbimi i ofruar mund të lehtësojë lëvizjen ose fshehjen e të ardhurave të kriminit. Kur një auditues/kontabilist nuk ka ekspertizën/kompetencën e duhur, nuk duhet të pranojë angazhimin apo klientin.
- c) Duhet të tregohet vëmendje ndaj treguesve që sinjalizojnë për problematika: të ushtrohet vigjilenca për të identifikuar dhe shqyrtuar më pas aspektet e transaksionit nëse ekzistojnë arsye të arsyeshme për të dyshuar se fondet janë të ardhura të një veprimtarie kriminale, ose të lidhura me financimin e terrorizmit. Këto raste do të shkaktonin detyrime të raportimit. Dokumentimi i procesit të mendimit duke pasur një plan veprimi mund të jetë një mundësi e vlefshme për të ndihmuar në interpretimin / vlerësimin e sinjaleve / treguesve të dyshimit. Në vijim të shqyrtohet nëse ka nevojë të merren masa dhe veprime konkrete.
- d) Rezultatet e veprimit të mësipërm (d.m.th. vlerësimi gjithëpërfshirës i rrezikut të një klienti / transaksioni të veçantë) do të diktojnë nivelin dhe natyrën e provave / dokumentacionit të mbledhur nën procedurat e vigjilencës së duhur dhe vigjilencës së zgjeruar të subjektit (përfshirë evidencën e burimit të pasurisë ose fondeve të klientit).
- e) Subjektet duhet të dokumentojnë dhe regjistrojnë në mënyrë të duhur hapat e ndërmarrë nën (a) deri në d).



Përsa i përket faktorëve të rrezikut të identifikuar si në vijim, subjektet (auditues ligjorë) duhet të marrin në shqyrtim faktorët e rrezikut të mashtrimit në pajtueshmëri me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit 240: Përgjegjësitë e audituesit në lidhje me mashtrimin në auditimin e pasqyrave financiare (ISA240) dhe shembujt e kushteve dhe ngjarjeve që mund të tregojnë rreziqe të anomalive materiale në Standardin Ndërkombëtar të Auditimit 315: Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve të anomalive materiale përmes të njohjes dhe kuptueshmërisë së entitetit dhe mjedisit të tij (ISA315).

Edhe kur subjekti (audituesi/kontabilisti) nuk po kryen një auditim, ISA 240 dhe ISA 315 ofrojnë lista të dobishme të sinjaleve për veprime të gabuara.

Subjektet konsiderojnë faktorë gjerësisht të pranuar (më të përdorur) të identifikimit dhe matjes së rrezikut, të cilët janë:

- (a) rreziku gjeografik/vend ndodhjes;
- (b) rreziku i klientit dhe;
- (c) rreziku i transaksionit/shërbimit i shoqëruar nga rreziku i kanalit të ofrimit të shërbimit.

Rreziku gjeografik/vend ndodhjes:

Një klient mund të jetë me rrezik më të lartë kur natyra e biznesit të tyre janë të lidhur me një vend me rrezik më të lartë për sa i përket:

- origjinën, ose vendndodhjen aktuale të burimit të pasurisë ose fondeve
- vendi ku ofrohet shërbimi;
- vendi ku klienti ka themeluar shoqërinë ose vendbanimi i përhershëm i klientit
- vendndodhjen e operacioneve kryesore të klientit
- vendi i banimit të pronarit përfitues; ose
- vendi i themelimit apo vendndodhjes të operacioneve kryesore të shoqërisë që synohet të blihet/bashkohet apo përthithet.

Nuk ka një përcaktim të pranuar në mënyrë universale për një vend me rrezik më të lartë apo zonë gjeografike, por subjektet duhet t'u kushtojnë vëmendje atyre vendeve që janë:

- Vende / zona të identifikuar nga burime të besueshme se sigurojnë fonde ose mbështetje për aktivitete terroriste ose që kanë organizata të caktuara terroriste që veprojnë brenda tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

- Vendet e identifikuara nga burime të besueshme se kanë nivele të konsiderueshme të krimit të organizuar, korrupsionit ose aktivitetit tjetër kriminal, përfshirë vendet e burimit ose të tranzitit për drogë të paligjshme, trafikimin e qenieve njerëzore dhe kontrabandën dhe lojërat e paligjshme.
- Vendet që i nënshtrohen sanksioneve, embargove ose masave të ngjashme të lëshuara nga organizata ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara.
- Vendet e identifikuara se kanë qeverisje të dobët në zbatimin e ligjit, dhe regjime rregullatore, përfshirë vendet e identifikuara nga deklaratat FATF që kanë regjime të dobëta PPP/FT përsa i përket institucioneve financiare (gjithashtu edhe të profesioneve të caktuara të lira jo financiare), duhet t'i kushtohet vëmendje të veçantë marrëdhënieve të biznesit dhe transaksioneve të tyre.

Rreziku i klientit

Faktorët kryesorë të rrezikut që lidhen me klientin/angazhimin që duhet të mbahen parasysh nga audituesit/kontabilistët janë:

- Portofoli i klientëve të subjektit përbëhet nga industri ose sektorë ku mundësitë për PP/FT janë veçanërisht të larta.



- Klientët e subjektit përfshijnë PEP ose persona të lidhur ngushtë ose të lidhur me PEP, të cilët konsiderohen si klientë me rrezik më të lartë.

Konsiderata të veçanta për Personat e Ekspozuar Politikisht dhe burimin e fondeve dhe pasurisë të tyre

Nëse një subjekt po ofron shërbimet e tij (auditim, kontabilitet, konsulencë tatimore etj) një klient të PEP, ose ku një PEP është pronari përfitues i pasurive në një transaksion, kërkohet ushtrimi i vigjilencës së zgjeruar në veçanti nëse janë të përfshira në transaksionet e përcaktuara në nenin 3 gërma gj) (i) deri (v) të ligjit 9917/2008 për PPP/FT. Masat e tilla përfshijnë, marrjen e miratimit të drejtimit të lartë (p.sh. partneri i vjetër, partneri drejtues ose drejtuesit ekzekutiv) përpara se të krijoni një marrëdhënie biznesi apo para pranimit/vazhdimin të angazhimit, duke marrë masa të arsyeshme për të identifikuar burimin e pasurisë dhe burimit të fondeve të klientëve dhe pronarëve përfitues të identifikuar si PEP, dhe të kryhet monitorimi i zgjeruar i vazhdueshëm të kësaj marrëdhënie.

Burimi i fondeve dhe burimi i pasurisë janë të rëndësishme për përcaktimin e profilit të rrezikut të një klienti. Burimi i fondeve është aktiviteti që gjeneron fonde për një klient (p.sh. paga, të ardhurat nga tregtimi ose pagesat nga trustet). Burimi i fondeve lidhet drejtpërdrejt me origjinën e vërtetë të fondeve që do të përdoren në një transaksion. Kjo ka të ngjarë të jetë një llogari bankare dhe shpesh do të jetë e mbështetur në ekstraktet e bankës apo në dokumentacion të ngjashëm. Burimi i pasurisë konsiston në aktivitetet që kanë gjeneruar vlerën totale neto të një klienti (p.sh. nga pronësia e një biznesi, trashëgimia ose investimet). Burimi i pasurisë është origjina e vlerës së përlogaritur të pasurisë së një individi. Kuptimi i burimit të pasurisë ka të bëjë me ndërmarrjen e hapave të arsyeshëm për t'u siguruar që fondet që do të përdoren në një transaksion/e që nuk është/janë të ardhura nga krimi.

Ndërsa burimi i fondeve dhe pasuria mund të jenë të njëjta për disa klientë, ato mund të jenë pjesërisht ose plotësisht të ndryshme për klientët e tjerë. Për shembull, një PEP që merr një pagë modeste zyrtare, por që ka fonde të konsiderueshme, pa zotëruar pjesmarrje apo interesa në ndonjë biznes apo nga trashëgimia, mund të krijojë dyshime për ryshfet, korrupsion ose keqpërdorim të pozitës. Sipas metodologjisë së qasjes në rrezik, subjektet duhet të sigurohen që informacioni i duhur është i disponueshëm për të vlerësuar burimin e fondit dhe burimin e pasurisë së një klienti si të ligjshëm me një shkallë sigurie që është në përpjesëtim me profilin e rrezikut të klientit.

Faktorët përkatës që ndikojnë në shtrirjen dhe natyrën e vigjilencës së ushtruar përfshijnë rrethanat e veçanta të një PEP, interesave të veçantë të biznesit të PEP dhe periudhën që ato interesa mbizotërojnë në lidhje me pozicionin publik, nëse PEP ka akses në fondet zyrtare, merr vendime në lidhje me alokimin e fondeve publike ose kontratave të prokurimit publik, vendi i lindjes i PEP, lloji i veprimtarisë që PEP po i kërkon subjektit që të kryejë, nëse PEP është vendas ose ndërkombëtar, veçanërisht duke pasur parasysh shërbimet e kërkuara, dhe kontrollin mbi të cilin PEP është nën vendin e origjinës së PEP.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

- Klientët që zhvillojnë marrëdhëniet e tyre të biznesit ose kërkojnë shërbime në rrethana të pazakonta ose jokonvencionale (të vlerësuara duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e përfaqësimit të klientit).
- Klientë kur struktura ose natyra e njësisë ekonomike ose marrëdhënies e bën të vështirë të identifikojnë në kohën e duhur pronarin e vërtetë përfitues ose interesin kontrollues ose klientët që përpiqen të fshehin kuptueshmërinë e natyrës së biznesit të tyre, pronësisë ose natyrën e transaksioneve të tyre, të tilla si:
 - o Përdorimi i pashpjegueshëm i shoqërive guaskë dhe / ose shoqërive fiktive, personave juridikë me pronësi përmes përfaqësuesve ligjorë ose aksioneve të bartësit, kontrollit përmes përfaqësuesve ligjorë dhe drejtorëve të korporatave, personave juridikë ose marrëveshjeve ligjore, ndarjen e themelimit të kompanisë dhe administrimit të pasurive në vende të ndryshme, të gjitha pa asnjë qëllim të dukshëm biznesi, ekonomik, ligjor, tatimor ose arsye tjetër.
 - o Përdorimi i pashpjegueshëm i kombinimeve joformale siç janë familja ose bashkëpunëtorët e afërt që veprojnë si aksionarë ose drejtorë të nominuar.
 - o Kompleksiteti i pazakontë në strukturat e kontrollit ose pronësisë pa shpjegim të qartë, ku rrethanat e caktuara, struktura, vendndodhja gjeografike, aktivitetet ndërkombëtare ose faktorë të tjerë nuk janë në përputhje me kuptueshmërinë e subjekteve për qëllimin e biznesit dhe të biznesit të klientit.
- Shoqëri të klientëve që pjesën më të madhe të operacioneve të biznesit të tyre apo kanë filialet kryesore në rajone me rrezik të lartë.
- Klientë, biznesi i të cilëve është bazuar në para fizike. Kur këta klientë janë tërësisht subjekt i masave rregullatore të PPP/FT në pajtueshmëri me rekomandimet e FATF, i shërben zbutjes së rreziqeve. Klientë me intensitet të lartë paraje fizike mund të përfshijnë për shembull:
 - o Bizneset e Shërbimeve të Transferimit të Parave ose vlerave (p.sh. zyrat e këmbimit valutor, agjentë të transferimit të parave apo të tregtimit të kartëmonedhave ose biznese të tjera që ofrojnë lehtësira transferimi të parave);
 - o Operatorët, ndërmjetësit dhe të tjerët që ofrojnë shërbime në mjete virtuale
 - o Kazinotë, shoqëritë e basteve dhe aktivitetet e tjera të lidhura me lojërat e fatit;
 - o Tregtarët e gurëve dhe metaleve të çmuara
- Bizneset që në rrjedhën normale të biznesit nuk kanë sasi të larta të parasë fizike, papritmas mund të disponojnë sasi të konsiderueshme të parave fizike.
- Organizatat jofitimprurëse ose bamirëse që kryejnë transaksione për të cilat duket se nuk ka ndonjë qëllim logjik ekonomik ose kur nuk duket se ka asnjë lidhje midis veprimtarisë së deklaruar të organizatës dhe palëve të tjera në transaksion.
- Klientë që duket se po veprojnë sipas udhëzimeve të dikujt tjetër, pa e zbuluar identitetin e tij.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

- Klientët që duket se shmangin vazhdimisht takimet ballë për ballë ose që japin udhëzime me ndërprerje pa arsye legjitime dhe ndryshme mund të konsiderohen si evazive ose shumë të vështira për t'u arritur, në rrethana të cilat nuk do të ndodhnin normalisht.
- Klientët që kërkojnë që transaksionet të kryhen në afate kohore jashtëzakonisht të ngushta apo të nxituara pa një shpjegim të arsyeshëm për urgjencën e kryerjes së transaksionit, gjë që do ta bënte të vështirë ose të pamundur për subjektet që të kryejnë një vlerësim të duhur të rrezikut.
- Klientë të dënuar më parë për krime që kanë gjeneruar të ardhura, të cilët udhëzojnë subjektet (të cilët kanë dijeni për dënimin e klientit) të kryejnë disa aktivitete të caktuara në emër të tyre.
- Klientë që nuk kanë adresë, ose adresa të shumta të pa justifikuar.
- Klientët që kanë fonde që janë dukshëm dhe në mënyrë të pashpjegueshme joproporcionale me rrethanat e tyre (p.sh. mosha, të ardhurat, profesioni ose pasuria e tyre).
- Klientët që ndryshojnë marrëveshjet apo udhëzimet e ekzekutimit të urdhrave pa arsyetimin e përshtatshëm.
- Klientët që ndryshojnë mënyrat e pagesave për një transaksion në minutën e fundit dhe pa shpjegime (apo me shpjegime të dyshimta), ose kur ka një mungesë të pashpjegueshme të informacionit ose transparencës të transaksionit. Ky rrezik shtrihet në situatat kur ndryshimet e minutës së fundit janë bërë për të mundësuar që fondet të paguhen nga / jashtë tek një palë e tretë.
- Klientët që insistojnë, pa arsyetim ose shpjegim të përshtatshëm që transaksionet të kryhen ekskluzivisht ose kryesisht përmes përdorimit të mjeteve virtuale me qëllim ruajtjen e anonimitetit të tyre.
- Klientë të cilët janë të gatshëm të paguajnë tarifa të larta të pazakonta të cilat nuk justifikojnë nivelin e shërbimit. Sidoqoftë, marrëveshjet në mirëbesim dhe të përshtatshme që subjektet mund të marrin për realizimin me sukses të një shërbimi nuk duhet të konsiderohet si një faktor rreziku.
- Nivele të larta të pasurive të pazakonta ose transaksione jashtëzakonisht të mëdha në krahasim me ato që mund të priten në mënyrë të arsyeshme nga klientët me një profil të ngjashëm mund të tregojnë që një klient që nuk shihet ndryshe si rrezik më i lartë duhet të konsiderohet si i tillë.
- Kur ka transaksione të caktuara, struktura, vendndodhja gjeografike, aktivitete ndërkombëtare ose faktorë të tjerë që nuk janë në përputhje me kuptueshmërinë e subjektit për gjendjen e biznesit ose ekonomike të klientit.
- Klientët që dyshohet se janë të përfshirë në krijimin e aktiviteteve fiktive përmes përdorimit të kredive të rreme, faturave të rreme dhe krijimin e skemave mashtruese.
- Transferimi i selisë së një shoqërie në një juridiksion tjetër pa ndonjë veprimtari të mirëfilltë ekonomike në vendin e destinacionit paraqet rrezik për krijimin e shoqërive gauskë, të cilat mund të përdoren për të fshehur pronarin e fundit përfitues.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

- Raporti midis numrit të punonjësve / strukturës dhe natyrës së biznesit ndryshon nga norma e industrisë (p.sh. xhiroja e një kompanie është e paarsyeshme e lartë duke marrë parasysh numrin e punonjësve dhe aktiveve të përdorura në krahasim me biznese të ngjashme).
- Klienti ngurron të japë informacion të plotë apo subjekti ka dyshime të arsyeshme për të dyshuar se informacioni i dhënë është i pasaktë ose jo i plotë.
- Klientët që kërkojnë të fitojnë nënshtetësinë në vendin e themelimit të subjektit (audituesit/kontabilistit) në këmbim të transferimeve për kapitale, blerjes së pronave ose obligacioneve qeveritare, ose investimeve në korporata të mëdha.

Klientët e përmendur më lart mund të jenë individë që, për shembull, janë duke u përpjekur të fshehin interesat dhe pasuritë e tyre të biznesit ose klientët mund të jenë përfaqësues të drejtimit të lartë të një shoqërie, të cilët, për shembull, janë duke u përpjekur të fshehin strukturën e pronësisë.

Rreziku i transaksionit / shërbimit shoqëruar me rrezikun e kanalit të shpërndarjes.

Shërbimet që mund të ofrohen nga subjektet (audituesit/kontabilistët) dhe që (në disa rrethana) rrezikojnë të përdoren për të ndihmuar pastruesit e parave janë si në vijim:

- Përdorimi i pajustificuar i llogarive rezervë të klientëve ose ruajtja në depozita të sigurie apo asetëve të klientit.
- Rrethana ku konsulenca për krijimin e organizimeve ligjore mund të keqpërdoren për të fshehur pronësinë e vërtetë apo qëllimin e vërtetë ekonomik (përfshirë krijimin e trusteve, ndryshimin e emrit / selisë së shoqërisë ose themelimin e shoqërive me struktura komplekse pronësie). Kjo mund të përfshijë konsulenca në lidhje me krijimin e trusteve që i jep të mirëbesuarit të drejta emërimi për përfitues të cilët nuk përfshijnë përfituesin e vërtetë (p.sh. emërimi i një bamirësie si përfituesi i vetëm si fillimi me qëllimin për të shtuar përfituesit e vërtetë në faza të mëvonshme). Mund të karakterizohet gjithashtu nga situata kur krijohet një trust me qëllim të administrimit të aksioneve në një kompani me qëllimin për ta bërë më të vështirë përcaktimin e përfituesve të pasurive të menaxhuara nga trusti.
- Shërbime ku subjektet në praktikë mund të garantojnë për reputacionin dhe besueshmërinë e klientit ndaj palëve të treta, pa një njohuri të thelluar të biznesit të klientit.
- Shërbime që mundësojnë fshehjen e pronarit përfitues nga autoritetet kompetente.
- Shërbimet e kërkuara nga klienti për të cilat llogaritari subjekti nuk ka kompetenca apo njohuritë teknike, përveç kur subjekti i drejtohet një profesionisti i cili i ka njohuritë teknike dhe trajnimet e duhura për këtë konsulencë apo shërbim.
- Transferimet elektronike të parave përmes përdorimit të shumë transferimeve ndër-kompani brenda grupit për të shmangur gjurmimin nga auditimi dhe kontrolli.
- Shërbime që mbështeten shumë në teknologjitë e reja (p.sh. në lidhje me ofertat fillestare të monedhave ose pasuritë virtuale) që mund të kenë rrezik të vetvetishëm për t'u shfrytëzuar nga kriminelët, veçanërisht ato shërbime që nuk janë të rregulluara nga legjislacioni i PPP/FT.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

- Transferimi i pasurive të patundshme ose mallrave ose pasurive të tjera me vlerë të lartë midis palëve në një periudhë kohore që është jashtëzakonisht e shkurtër për transaksione të ngjashme, pa ndonjë arsye të dukshme ligjore, tatimore, biznesi, ekonomike ose arsye tjetër.
- Transaksione, për të cilat është evidente që subjekti nuk ka informacion të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm dhe kur klienti nuk jep një arsye të ligjshme për transaksionin.
- Marrëveshjet administrative që lidhen me pasuri ku i ndjeri njihet nga subjekti (audituesi/kontabilisti) si një individ i dënuar për të ardhura të gjeneruara nga krimi.
- Shërbime të cilat janë dhënë qëllimisht apo që varen shumë nga anonimiteti i identitetit të klientit apo ortakëve të tjerë, nga rrethanat normale që ka hasur subjekti në përvojën e tij të punës.
- Përdorimi i mjeteve virtuale dhe mjeteve të tjera anonime të pagesave dhe transferimit të pasurisë brenda transaksionit pa arsye të dukshme ligjore, tatimore, biznesi, ekonomike ose arsye të tjera të ligjshme.
- Transaksione të cilat kryhen duke përdorur mënyra të pazakonta pagese (p.sh. metale të çmuara ose gurë).
- Shtyrja e një pagese për një aktiv apo një shërbim të kryer në një moment të largët nga data kur normalisht pritet të ndodhë pagesa, pa garancitë e duhura që pagesa do të kryhet.
- Vendosja e pashpjegueshme e kushteve / klauzolave të pazakonta në marrëveshjet e kredisë që nuk pasqyrojnë pozitat negociuese midis palëve dhe mund të kërkojnë që subjektet të njohin rreziqet. Marrëveshjet që mund të jenë abuzive përfshijnë periudha të amortizimit jashtëzakonisht të shkurtër / të gjatë, normat e interesit materialisht mbi / nën tarifën e tregut, ose anulime të përsëritura të pashpjeguara të kolateraleve/garancive ose instrumenteve të tjera të garancisë, shumë përpara datës së maturimit të dakorduar fillimisht.
- Transferimet e mallrave që vetvetiu janë të vështira për t'u vlerësuar (p.sh. bizhuteri, gurë të çmuar, objekte arti ose antike, asete virtuale), në një tjetër njësi ekonomike pa shpjegimet e duhura, kur kjo nuk është e zakonshme për llojin e klientëve, transaksioneve, ose me rrjedhën normale të aktivitetit të subjektit (audituesit/ kontabilistit).
- Depozitimi vazhdueshëm i kapitaleve apo kontributeve të tjera brenda një periudhe të shkurtër kohe në të njëjtën njësi ekonomike pa asnjë arsye të dukshme ligjore, tatimore, biznesi, ekonomike ose ndonjë arsye tjetër e ligjshme.
- Blerjet e bizneseve në likuidim pa ndonjë arsye të dukshme ligjore, tatimore, biznesi, ekonomike ose ndonjë arsye tjetër të ligjshme.
- E drejta e përfaqësimit (prokurë) e lëshuar në kushte të pazakonta (p.sh. kur jepet në mënyrë të përvokueshme ose në lidhje me asete specifike) dhe kushtet e shpalosura janë të paqarta ose jo të arsyeshme.
- Transaksione që përfshijnë persona të lidhur ngushtë dhe për të cilët klienti dhe / ose konsulentët e tij financiar japin shpjegime jo të arsyeshme apo që bien në kundërshtim me rrethanat, dhe më tej nuk janë të gatshëm apo në gjendje të japin argumenta të bazuara në ligji, në llogjikën e biznesit, ekonomike apo arsye të tjera të ligjshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

- Rrethana ku një përfaqësues është duke u përdorur (p.sh. shoku ose anëtar i familjes emërohet si pronar i pasurisë / pasurive, kur është e qartë se miku ose anëtar i familjes po merr udhëzime nga pronari përfitues) pa ndonjë qëllim të dukshëm ligjor, tatimor, biznes, ekonomike ose qëllim tjetër të ligjshëm.
- Pagesa të përfituara nga një palë e tretë pa lidhje me klientin apo të panjohura dhe pagesa në para për honorare në raste kur nuk është një mënyrë tipike e pagesës.
- Transaksionet ose shërbimet tregtare të pasurive të patundshme që duhet të kryhen nga klienti pa ndonjë qëllim të dukshëm biznesi, ekonomik, tatimor apo qëllim tjetër të ligjshëm.
- Ekzistenca e dyshimeve në lidhje me transaksione fiktive apo transaksione tek të cilat mbështeten. Këto mund të përfshijnë:
 - o Mbi ose nën faturimi i mallrave apo shërbimeve
 - o Faturimi i shumëfishtë për të njëjtat mallra / shërbime.
 - o Mallrat / shërbimet e përshkuara dhe të transportuara në mënyrë fiktive (p.sh. shënime fiktive në faturat e transportit, fletë-hyrjeve/daljeve të magazinës etj)
 - o Tregtimi i shumëfishtë i mallrave / shërbimeve.

Variablat që mund të ndikojnë vlerësimin e rrezikut nga subjektet

- Subjektet duhet të ndjekin dhe zbatojnë standardet dhe kuadrin ligjor dhe rregullator të profesionit të tyre, një vëmendje duhet t'i kushtohet ndryshimeve në praktikimin e profesionit, madhësinë, shkallën dhe kompetencave profesionale të subjekteve auditues ligjorë/kontabilistë gjithashtu edhe bazës së klientëve të cilëve u ofrojnë shërbim. Për rrjedhojë faktorët e përmendur në këtë paragraf duhet të mbahen parasysh nga subjektet gjatë hartimit të programit të vlerësimit të rrezikut për PPP/FT.
- Një tjetër variabël për t'u mbajtur parasysh është kapaciteti i subjektit për të dedikuar dhe alokuar burimet në zbatim të hartimit të sistemeve për vlerësimin e rreziqeve nga PPP/FT. Për shembull një praktikues i vetëm nuk mundet të dedikojë të njëjtin nivel burimesh si një shoqëri auditimi/kontabiliteti e madhe. Një praktikues i vetëm zhvillon sistemet dhe kontrollet e rrezikut të PPP/FT në proporcion me natyrën dhe madhësinë e shërbimit dhe klientëve që ka. Për shembull shoqëri të vogla në qytete të vogla të cilat ofrojnë shërbim për një kategori klientësh me rrezik të ulët, niveli i burimeve dhe i vlerësimit të rrezikut do të jetë më i reduktuar. Në të tilla raste është më e arsyeshme që praktikuesit e vetëm për vlerësimin e rrezikut të PPP/FT, të mbështeten në informacionin e publikuar dhe atë që paraqitet nga klienti. Ndërkohë që shoqëritë e mëdha të auditimit/kontabilitetit me bazë të gjerë klientësh të niveleve të ndryshme të rrezikut do të kenë burime të dedikuara për procesin e vlerësimit të rrezikut të PPP/FT.
Në të gjitha rastet është e rëndësishme të vihet theksi në procesin e kryerjes së analizës dhe të vlerësimit të rrezikut të PPP/FT.



Shembuj të faktorëve që mund të shtojnë rrezikun janë:

- Shërbime të konsulencës të kërkuar me urgjencë të pa justifikuar
- Ndërlikime të pazakonta të procedurave të klientit, përfshirë kompleksitetin e mjedisit të kontrollit.
- Ndërlikime të pazakonta të transaksioneve apo skema të kryerjeve të tyre.
- Parregullsia ose kohëzgjatja e marrëdhënies së klientit. Angazhimet vetëm për një detyrë/shërbim të caktuar, që përfshin kontakt të kufizuara të klientit gjatë gjithë marrëdhënies mund të jetë tregues i një rreziku të lartë.

Shembuj të faktorëve që mund të zbusin rrezikun janë:

- Përfshirja e institucioneve financiare të rregulluara në mënyrë përshtatshme apo të profesionistëve të tjerë të rregulluar
- E njëjta vendndodhje e klientit dhe subjektit (auditues/kontabilist i miratuar)
- Roli ose mbikëqyrja e një rregullatori apo mbikëqyrje nga disa rregullatorë njëkohësisht.
- Rregullsia ose kohëzgjatja e marrëdhënies së klientit. Marrëdhëniet e gjata që përfshijnë kontakte të shpeshta me klientin dhe rrjedhjen e lehtë të informacionit përgjatë marrëdhënies mund të paraqesin më pak rrezik.
- Kompanitë private që janë transparente dhe të njohura në publik.
- Njohuritë e subjektit me një vend të caktuar, duke përfshirë pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret vendase, si dhe strukturën dhe shtrirjen e kërkesave të mbikëqyrjes nga rregullatori.

Dokumentimi i vlerësimit të rreziqeve

- Subjektet duhet të krijojnë një kuptueshmëri të rreziqeve të tyre të PPP/FT (për klientët, vendet ose zonat gjeografike, shërbimet, transaksionet ose kanalet e ofrimit). Ata duhet të dokumentojnë këto vlerësime në mënyrë që i tillë vlerësim të jetë i mbështetur dhe të ushtrojnë kujdesin e duhur profesional dhe të përdorin gjykim të mirë. Sidoqoftë, autoriteti mbikëqyrës dhe autoriteti përgjegjës mund të përcaktojnë edhe rrethana ku të mos jetë i nevojshëm dokumentimi i vlerësimit të rrezikut kur këto rreziqe janë identifikuar dhe kuptuar si duhet për sektorë të caktuar.
- Këto rreziqe duhet të vlerësohen sipas treguesve të rrezikut si rrezik i ulët, rrezik i mesëm dhe rrezik i lartë. Kategorizimi i rreziqeve duhet të përmbajë një shpjegim i shkurtër të arsyeve pse përcaktohet ky kategorizim rreziku. Vlerësimi duhet të shoqërohet me një plan veprimi (nëse është e zbatueshme) ku duhet të përshkruhet si pjesë e vlerësimit të rrezikut, datën. Është e rëndësishme që në vlerësimin e profilit të rrezikut të klientit në këtë fazë, të bëhet referencë në listat përkatëse të sanksioneve financiare (TFS- Listat e personave të shpallur) për të konfirmuar se as klienti dhe as pronari përfitues nuk është caktuar dhe përfshirë në ndonjë prej tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

- Ky vlerësim rreziku nuk duhet të jetë individual vetëm për secilin klient dhe shërbim specifik mbi baza individuale, por gjithashtu të përfshijë vlerësimin dhe dokumentimin e rreziqeve në bazë të gjerë dhe për të mbajtur vlerësimin e rrezikut të përditësuar, nëpërmjet monitorimit të marrëdhënies së klientit. Vlerësimi i rrezikut me shkrim duhet të jetë i aksesueshëm nga i gjithë personeli i ngarkuar për çështjet e PPP/FT.

Subjektet, në rast se rezultati (analiza e bërë) tregon për një rrezik të mundshëm, e mbështesin analizën në tërësinë e ekspozimit ndaj kriterëve të rrezikut, si dhe mbi variablat e rrezikut.

Disa prej masave shtesë për të administruar këtë ekspozim janë:

- informacion shtesë për profilin e klientit (Internet, baza të dhënash publike);
- rritje e frekuencës së përditësimit të të dhënave për klientin;
- marrjen e informacionit shtesë për burimin e fondeve;
- marrjen e informacionit shtesë për arsyet dhe qëllimin e transaksionit;
- marrja e miratimit nga drejtuesit e lartë për nisjen dhe vazhdimin e marrëdhënies së biznesit, në rastet kur marrëdhënia e biznesit me klientin është vendosur dhe subjekti konstaton se klienti apo pronari përfitues ka ndryshuar kategori;
- monitorim i zgjeruar.

Subjektet e mbikëqyrura gjatë vlerësimit të faktorëve rrezikut të PP/FT duhet të mbajnë parasysh dy variabla kryesorë për përcaktimin e nivelit të rrezikut :

1. Probabiliteti (mundësia) që faktori (gjeografik/klienti/transaksioni) të keqpërdorë njësinë ekonomike për PP/FT
2. Ndikimi që do të kishte nëse njësinë ekonomike do të përdorej për PP/FT.

Kështu nëse probabiliteti dhe ndikimi kategorizohen në tre nivele: i ulët, i mesëm i lartë, nga kombinimi i tyre subjekti do të përftojë një vlerësim të rrezikut të faktorëve të PP/FT, të kategorizuar në tre nivele: i ulët, i mesëm, i lartë.

Shembulli në vijim mbi vlerësimin e rrezikut të PP/FT është ilustrues :

Shoqëri tregti me pakicë

Probabiliteti: Një shoqëri tregtie me pakicë e cila ka intesitet të lartë të parasë fizike dhe një numër të konsiderueshëm që veprojnë në emër dhe për llogari të shoqërisë, shoqërohet me një probabilitet të mesëm që në këtë shoqëri të depozitohen fonde nga burime jo të ligjshme.

Ndikimi: Për shkak të numrit të madh të klientëve të shoqërisë ndikimi mund të jetë i madh.

Rreziku: Vlerësimi i rrezikut është i lartë.

Shoqëri ndërkombëtare



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Probabiliteti: Klientët që janë shoqëri ndërkombëtare, mund të kenë një strukturë komplekse të pronësisë dhe shpeshherë të themeluar në vende të "parajsës fiskale", kanë një probabilitet të lartë të PP/FT.

Ndikimi: Duke qënë se numri i klientëve është i kufizuar kanë një ndikim të mesëm.

Rreziku: Vlerësimi i rrezikut është i mesëm.

Në mënyrë tabelare analiza e mësipërme do të përmbliidhej:

<i>Tipologjia e klientit</i>	<i>Probabiliteti</i>	<i>Ndikimi</i>	<i>Vlerësimi i rrezikut</i>
Shoqëri tregti me pakicë	i lartë	i lartë	Rrezik i lartë
Shoqëri ndërkombëtare	i lartë	i mesëm	Rrezik i mesëm
Shoqëri e listuar në bursë	i ulët	i ulët	Rrezik i ulët
Person i ekspozuar politikisht	i lartë	i lartë	Rrezik i lartë
Klient i rastësishëm	i lartë	i mesëm	Rrezik i mesëm
<i>Tipologjia e shërbimit</i>	<i>Probabiliteti</i>	<i>Ndikimi</i>	<i>Vlerësimi i rrezikut</i>
Përdorimi i transaksioneve elektronike	i lartë	i lartë	Rrezik i lartë
Transferimet elektronike të parave në shoqëritë brenda grupit për të shmangur gjurmimin nga auditimi dhe kontrolli.	i lartë	i lartë	Rrezik i lartë
Shërbime që të themelimit dhe regjistrimet në organet tatimore	i mesëm	i mesëm	Rrezik i mesëm
Shërbime të pagesave brenda vendit	i ulët	i ulët	Rrezik i ulët

Kështu nëse do të kombinohej në një matricë ku do të kombinohen klient dhe shërbimit të ofruar rezultati i analizës së vlerësimit të rrezikut do të ishte si në tabelën më poshtë:

<i>Shërbimi</i> <i>Tipologjia e klientit</i>	Përdorimi i transaksioneve elektronike	Transferimet elektronike të parave në shoqëritë brenda grupit për të shmangur gjurmimin nga auditimi dhe kontrolli.	Shërbime që të themelimit dhe regjistrimet në organet tatimore	Shërbime të pagesave brenda vendit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Shoqëri tregti me pakicë	Rrezik i lartë	N/A	Rrezik i Mesëm	Rrezik i Mesëm
Shoqëri ndërkombëtare	Rrezik i mesëm	Rrezik i lartë	Rrezik i Mesëm	Rrezik i Mesëm
Shoqëri e listuar në bursë	Rrezik i ulët	Rrezik i mesëm	Rrezik i ulët	Rrezik i ulët
Person i ekspozuar politikisht	Rrezik i lartë	Rrezik i lartë	Rrezik i lartë	Rrezik i mesëm
Klient i rastësishëm	Rrezik i mesëm	Rrezik i lartë	Rrezik i mesëm	Rrezik i mesëm